

PHILIPS

Seria 1000

Boks SoundBar

HTL1520B

Manuali i përdorimit



Regjistroni produktin tuaj dhe merrni ndihmë në
www.philips.com/support

Përbajtja

| | |
|---|-----------|
| 1 Të rëndësishme | 2 |
| Ndihmë dhe mbështetje | 2 |
| Udhëzime të rëndësishme sigurie | 2 |
| Kujdesi për produktin tuaj | 3 |
| Kujdesi për mjedisin | 3 |
| Pajtueshmëria | 4 |
| 2 SoundBar juaj | 4 |
| Njësia kryesore | 4 |
| Telekomanda | 5 |
| Konektorët | 6 |
| 3 Lidhja | 6 |
| Vendosja | 6 |
| Lidhni SoundBar dhe Subwoofer | 7 |
| Lidheni Subwoofer manualisht | 7 |
| Lidhni audion nga televizori dhe pajisje të tjera | 8 |
| 4 Përdorimi i SoundBar | 9 |
| Rregulloni volumin | 9 |
| Aparati MP3 | 9 |
| Luajtja e audios nëpërmjet Bluetooth | 10 |
| Gjendje pritjeje automatike | 10 |
| Vendosja e konfigurimeve të fabrikës | 10 |
| Përditësimi i softuerit | 10 |
| 5 Montimi në mur | 11 |
| 6 Të dhënat e produktit | 11 |
| 7 Zgjidhja e problemeve | 12 |

I Të rëndësishme

Lexoni dhe kuptoni të gjitha udhëzimet para se ta përdorni produktin. Garancia nuk është e vlefshme nëse dëmtimi shkaktohet nga mosndjekja e udhëzimeve.

Ndihmë dhe mbështetje

Për mbështetje intensive online, viziton www.philips.com/support to:


- shkarkoni manualin e përdorimit dhe udhëzuesin e shpejtë
- shikoni udhëzuesit me video (të disponueshme vetëm për disa modele)
- gjeni përgjigje për pyetje të bëra shpesh (FAQ)
- na dërgoni pyetje me email
- bisedoni me përfaqësuesit tanë.

Ndiqni udhëzimet në faqen e internetit për të zgjedhur gjuhën, dhe më pas vendosni numrin e modelit të produktit

Ose mund të kontaktoni shërbimin e klientit në vendin tuaj. Para se të kontaktoni, mbani shënim numrin e modelit dhe numrin e serië së produktit. Mund t'i gjeni këto informacione mbrapa ose poshtë produktit.

Udhëzime të rëndësishme sigurie

- Lexoni këto udhëzime.
- Ruajini këto udhëzime.
- Përbajuni të gjitha paralajmërimet.
- Ndiqni të gjitha udhëzimet.
- Mos e përdorni këtë aparat pranë ujit.
- Pastrojeni vetëm me lekçë të thatë.
- Mos i bllokoni hapësirat e ajrimit.
- Instalojeni sipas udhëzimeve të prodhuesit.
- Mos e instaloni pranë asnjë burimi nxehësie si për shembull radiatoret, pajisje ngroheje,



soba, ose pajisje të tjera që prodhojnë nxehësie (përfshirë edhe amplifikatorët).

- **Mos e anashkaloni qëllimin e sigurisë së spinës së polarizuar ose me tokëzim.** Një spinë e polarizuar ka dy kunja ku njëra prej tyre është më e gjërë se tjetra. Një spinë me tokëzim ka dy kunja dhe një tjetër për tokëzimin. Kunja më e gjërë ose kunja e tretë është për sigurinë tuaj. Nëse spina e dhënë nuk futet në prizën tuaj, konsultohuni me një elektricist për të ndërruar prizën.
- **Mbrojeni kordonin e energjisë** në mënyrë që të mos shklet ose të mos kafshohet padashur te spina, priza, dhe në pikën ku del nga pajisja.
- **Përdorni vetëm shtesa/aksesorë** të specifikuara nga prodhuesi.
- **Përdorenët vetëm me karrocë**, mbajtëse, tripod, klapë ose tavolinë të specifikuara nga prodhuesi, ose që shitet bashkë me pajisjen. Kur përdoret karrocë, bëni kujdes kur lëvizni karrocën bashkë me aparatin për të mos rezikuar që ta rrëzonî.
- **Shkëputeni këtë pajisja nga priza** gjatë stuhive me vetëtimë ose kur nuk përdoret për kohë të gjatë.
- **Drejtovuni personelit të kualifikuar** të shërbimit për të gjitha riparimet. Riparimet kërkohen kur pajisja është dëmtuar në ndonjë mënyrë, si për shembull kordonin ose spina e energjisë është dëmtuar, është derdhur lëng ose kanë rënë objekte brenda në pajisje, pajisja është ekspozuar ndaj shiut ose lagështisë, nuk punon normalisht, ose është rrëzuar.
- **KUJDES lidhur me përdorimin e baterisë** - Për të mos lejuar rrjedhjet e baterive të cilat mund të shkaktojnë lëndime, dëmtime të pronës, ose dëmtime të aparatit:
 - Montojini **të gjitha** bateritë si duhet, + dhe - siç janë shënuar në aparat.
 - Mos i përzieni bateritë (**të rejet** me të vjetrat, ose ato prej **karboni** me ato **alkaline**, etj.).
 - Hiqini bateritë kur aparatit nuk përdoret për kohë të gjatë.



- Bateritë nuk duhet të ekspozohen ndaj dritës direkte të diellit, zjarrit ose burimeve të ngjashme të nxehësisë.
- Material perklorati - mund të jetë e nevojshme të trajtohet në mënyrë të veçantë. Shikoni www.dtsc.ca.gov/hazardouswaste/perchlorate.
- Produkti/telekomanda mund të ketë një bateri të tipit monedhë/kopsë, e cila mund të gjëlltitet padashur. Mbajeni gjithnjë larg nga fëmijët! Nëse gjëlltitet, bateria mund të shkaktojë lëndime serioze ose vdekje. Mund të ndodhin djegie të rënda brenda dy orësh pas gjëlltitjes.
- Nëse dyshoni se një bateri është gjëlltitur ose është futur në ndonjë pjesë të trupit, kërkoni menjëherë ndihmë mjekësore.
- Kur ndërroni bateritë, mbajini gjithnjë bateritë e reja dhe ato të përdorura larg fëmijëve. Sigurohuni që vendi i baterisë të jetë krejt i sigurt pasi ta ndërroni baterinë.
- Nëse vendi i baterisë nuk mund të sigurohet komplet, mos e përdorni më produktin. Mbajeni larg fëmijëve dhe kontaktoni prodhuesin
- **Aparati nuk duhet të ekspozohet ndaj pikave ose spërkatjeve.**
- **Mos vendosni asnje burim rreziku mbi pajisje** (për shembull, objekte të mbushura me lëng, qirinj të ndezur).
- Ky aparat mund të përbajë plumb dhe mërkur. Hidheni sipas ligjeve vendëse, shtetërore dhe federale. Për informacione lidhur me hedhjen ose riciklimin, ju lutemi kontaktioni www.mygreenelectronics.com ose www.eiae.org ose www.recycle.philips.com.
- Aty ku spina e energjisë ose një bashkues i pajisjes përdoret për si mjet shkëputjeje, pajisja e shkëputjes duhet të jetë në një vend që arrihet me lehtësi.
- Mos e vendosni këtë aparat mbi mobilie që mund të anohen nga një fëmijë ose një i rritur kur mbështetet, e tërheq, qëndron në këmbë ose hip sipër tyre. Nëse aparat bie, mund të shkaktojë lëndime të rënda ose madje vdekje.

- Ky aparat nuk duhet të vendoset në një instalim të brendshëm si për shembull në dollap librash ose në raft, përvëç nëse ka ajrim të mirë. Sigurohuni që të lini hapësirë prej 20 cm ose më shumë anembanë këtij aparatit.

Simboli i pajisjes Klasi II



Ky simbol tregon se aparatit ka sistem izolimi të dyfishtë.

Njihuni me këto simbole sigurie



Kjo shenjë "rrufeje" tregon se materiali i paizoluar brenda aparatit mund të shkaktojë goditje elektrike. Për sigurinë e të gjithëve në familjen tuaj, ju lutemi mos e hiqni mbulesën e aparatit.



"Pikëcuditja" tërheq vëmendjen ndaj veçorive për të cilat duhet të lexoni me kujdes literaturën e dhënë me qëllim që të parandalohen problemet e përdorimit dhe mirëmbajtjes.

PARALAJMËRIM: Për të pakësuar rrezikun e zjarrit ose goditjeve elektrike, ky aparat nuk duhet të ekspozohet ndaj shiut ose lagështisë, dhe objektet me lëngje, siç mund të janë vazot nuk duhen vendosur mbi këtë aparat.

KUJDES: Për të parandaluar goditjet elektrike, puthiteni kunjën e gjerë të spinës me vrimën e gjerë, dhe futeni plotësisht.

Kujdesi për produktin tuaj

Përdorni leckë me mikrofibra për ta pastruar produktin.

Kujdesi për mjedisin

Hedhja e produktit të vjetër dhe e baterive



Produkti është projektuar dhe prodhuar me materiale dhe komponentë të cilësisë së lartë, të cilat mund të riciklohen dhe të ripërdoren.



Ky simbol mbi një produkt do të thotë se produkti mbulohet nga Direktiva Evropiane 2012/19/EU.



Ky simbol do të thotë se produkti përmban bateri që mbulohen nga Direktiva Evropiane 2013/56/EU të cilat nuk mund të hidhen së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Informohuni lidhur me sistemet vendëse për grumbullimin e produkteve elektrike dhe elektronike dhe të baterive. Ndiqni rregullat vendëse dhe asnjëherë mos e hidhni produktin dhe bateritë së bashku me mbetjet e zakonshme shtëpiake. Hedhja e duhur e produkteve të vjetra ndihmon në parandalimin e pasojave negative përmes përdorimit të shëndetin e njeriut.

Heqja e baterive njëpërdorimëshe

Për t'i hequr bateritë njëpërdorimëshe, shikoni pjesën përmontimin e baterive.

Pajtueshmëria


Ky produkt i përbahet kërkeseve të Komunitetit Evropian për interferencat radio. Këtu, MMD Hong Kong Holding Limited deklaron se ky produkt është në përputhje me kërkasat themelore dhe masat e tjera përkatëse të Direktivës 2014/53/EU. Mund ta gjeni deklaratën e konformitetit në www.p4c.philips.com.

2 SoundBar juaj

Urime për blerjen tuaj, dhe mirë se vini në Philips! Për të përfituar plotësisht nga mbështetja që jep Philips, regjistroni SoundBar në www.philips.com/welcome.

Njësia kryesore

Kjo pjesë përmban një përbledhje të njësisë kryesore.



① ⌂

Ndizeni SoundBar ose çojeni në gjendje priteje.

② ⓧ (SOURCE)

Zgjidhni një burim për SoundBar.

③ Volume+/-

Rritni ose ulni volumin.


④ Treguesi LED i SoundBar

- Ndizet në ngjyrë të kuqe kur SoundBar është në gjendje priteje.
- Ndizet në ngjyrë jeshile kur ndryshoni linjën e burimit të hyrjes (kabull audio stereo 3,5 mm).

- Ndizet ngjyrë blu kur kaloni në modalitetin Bluetooth dhe pajisjet Bluetooth janë lidhur.
 - Ndizet në ngjyrë të verdhë kur kaloni në burimin e hyrjes optike.
 - Pulson në ngjyrë të kuqe kur rritni ose ulni volumin, qëndron në ngjyrë të kuqe kur rritni ose ulni volumin në maksimum ose minimum.
 - Pulson në ngjyrë të kuqe me ritëm të ulët kur e heshtni SoundBar.
- ⑤ Treguesi LED i Subwoofer
- Pulson ngjyrë të kuqe para se të lidhet me SoundBar.
 - Ngjyrë jeshile solide kur lidhet me sukses me SoundBar.

Telekomanda


Kjo pjesë përmban një përbledhje të telekomandës.



- ① **∅ (Standby-On)**
Ndizeni SoundBar ose çojeni në gjendje pritejje.
- ② **LINE**
Kaloni në modalitetin LINE IN.
- ③ **Bluetooth pairing**
Kaloni në modalitetin Bluetooth.
- ④ **+/- (Volume)**
 - Rritni ose ulni volumin.
- ⑤ **Butonat e luajtjes / Bluetooth PAIRING**
 - ▶ II: Luan, ndaloni ose vazhdoni luajtjen në modalitetin Bluetooth (vetëm për pajisjet Bluetooth me mbështetje AVRCP).
 - ◀ / ▶: Kapërceni te kënga e mëparshme ose te kënga tjetër në modalitetin Bluetooth (vetëm për pajisjet Bluetooth me mbështetje AVRCP).
 - ▶ II (Shtypje e gjatë): Shkëputeni pajisjen Bluetooth të lidhur aktualisht dhe filloni një çiftim të ri
- ⑥ **SOUND**
Zgjidhni modalitetin Muzikë, Film ose Lajme.
- ⑦ **OPT**
Kalojeni burimin e audios te lidhja optike.
- ⑧ **🔇**
Heshtni ose riktheni volumin.

Konektorët

Kjo pjesë përmban një përbledhje të konektorëve të disponueshëm në SoundBar



① HDMI (ARC)

Lidhuni me hyrjen HDMI në televizor.

② SERVICE

Për përditësimin e softuerit.

③ AUX IN

Hyre audio, për shembull, nga një aparat MP3 (xhek 3,5 mm).

④ OPTICAL

Lidhuni me një dalje audio optike në televizor ose në një pajisje digitale.

⑤ DC IN

Lidheni SoundBar me energjinë.

⑥ AC IN

Lidheni Subwoofer me energjinë.

3 Lidhja


Kjo pjesë ju ndihmon që ta lidhni SoundBar me një televizor ose me pajisje të tjera. Për informacion rreth lidhjeve bazë të SoundBar dhe aksesorëve, shikoni udhëzuesin e shpejtë.

Shënim


- Për identifikimin dhe të dhënat për energjinë, shikoni etiketën e të dhënave mbrota ose poshtë produktit.
- Para se të bëni ose të ndryshoni ndonjë lidhje, sigurohuni që të gjitha pajisjet të janë të shkëputura nga priza.

Vendosja

Vendoseni SoundBar siç tregohet më poshtë.



Lidhni SoundBar dhe Subwoofer



Lidheni Subwoofer manualisht

- Nëse nuk dëgjohet audio nga Subwoofer ose treguesi i Subwoofer nuk është blu, ndiqni hapat e mëposhtëm për ta resetuar dhe lidhur Subwoofer përsëri:
 1. Fileni Subwoofer dhe ndizeni SoundBar
 2. Mbani shtypur butonin "SOURCE" në SoundBar për 5 sekonda për të nisur kërkimin automatik.
 3. Ndizeni Subwoofer, treguesi do të jetë ngjyrë blu pasi ka pulsuar në ngjyrë të kuqe për 8 sekonda, që do të thotë se është bërë lidhja e suksesshme me SoundBar.




Lidhni SoundBar dhe Subwoofer me anë të Bluetooth.

- Subwoofer do të lidhet me SoundBar me anë të sinjalit Bluetooth.
- Treguesi i Subwoofer do të pulsojë në ngjyrë të kuqe para se të lidhet me SoundBar, dhe do të tregojë ngjyrë blu solide pasi është lidhur me SoundBar.
- Nëse SoundBar dhe Subwoofer janë lidhur përpara, kur lidhni dhe ndizni përsëri SoundBar, Subwoofer do të lidhet automatikisht me SoundBar me daljen normale të zërit dhe me tregues ngjyrë blu solide. Dhe Subwoofer do të fiket automatikisht pasi fiket SoundBar.

Lidhni audion nga televizori dhe pajisje të tjera


Opsioni 1: Lidhni audion nëpërmjet një kablli digital optik

Cilësia më e mirë e audios



- 1 Duke përdorur një kabull optik, lidhni konektorin **OPTICAL** në SoundBar me konektorin **OPTICAL OUT** në televizor ose në pajisjen tjetër.
 - Konektori optik digital mund të jetë emërtuar **SPDIF** ose **SPDIF OUT**.


Opsioni 2: Lidhni audion nëpërmjet një kablli audio stereo 3,5 mm



- 1 Duke përdorur një kabull audio stereo 3,5 mm, lidhni konektorin **LINE IN** në SoundBar me konektorin **LINE** në televizor ose në pajisjen tjetër.

Opsioni 3: Lidhuni me portën HDMI (ARC)

SoundBar mbështet HDMI me Audio Return Channel (ARC). Nëse televizori juaj është i pajtueshëm me HDMI ARC, mund ta dëgjoni audion e televizorit nëpërmjet SoundBar duke përdorur një kabull HDMI të vetëm.



- 1 Duke përdorur kabull High Speed HDMI, lidhni konektorin **HDMI OUT (ARC)-TO-TV** në SoundBar me konektorin **HDMI ARC** në televizor.
 - Konektori **HDMI ARC** në televizor mund të jetë emërtuar ndryshe. Për hollësi, shikoni manualin e përdorimit.
- 2 Në televizor aktivizoni veprimet e HDMI-CEC. Për hollësi, shikoni manualin e përdorimit.

4 Përdorimi i SoundBar

Kjo pjesë ju ndihmon ta përdorni SoundBar për të luajtur audio nga pajisjet e lidhura.

Para se të filloni

- Bëni lidhjet e nevojshme të treguara në udhëzuesin e shpejtë ose shkarkoni manualin e përdorimit në www.philips.com/support.
- Kalojeni SoundBar te burimi i duhur për pajisjet e tjera.

Aparati MP3

Lidheni aparatin MP3 për të luajtur skedarë audio ose muzikë.

Çfarë ju duhet

- Një aparat MP3.
 - Një kabull audio stereo 3,5 mm.
- 1** Duke përdorur kabullin audio stereo 3,5 mm, lidheni aparatin MP3 me konektorin **AUDIO IN** në SoundBar.
- 2** Shtypni **AUDIO IN** në telekomandë.
- 3** Shtypni butonat në aparatin MP3 për të zgjedhur dhe luajtur skedarë ose muzikë.

Rregulloni volumin

- 1** Shtypni +/- (Volume) për të rritur ose ulur nivelin e volumit.
- Për ta heshtur zérin, shtypni .
 - Për të rikthyer zérin, shtypni  përsëri ose shtypni +/- (Volume).

Treguesi i volumit

- Kur shtypni Volume+ për të rritur volumin, treguesi i SoundBar do të pulsojë në ngjyrë të kuqe, dhe volumi do të kthehet në gjendjen normale pasi të arrijë maksimumin dhe treguesi i SoundBar tregon ngjyrë të kuqe solide për 2 sekonda.
- Kur shtypni Volume- të ulur volumin, treguesi i SoundBar do të pulsojë në ngjyrë të kuqe, dhe volumi do të kthehet në gjendjen normale pasi të arrijë minimumin dhe treguesi i SoundBar tregon ngjyrë të kuqe solide për 2 sekonda.

Luajta e audios nëpërmjet Bluetooth

Duke përdorur Bluetooth, lidheni SoundBar me pajisjen Bluetooth (si iPad, iPhone, iPod touch, telefon Android, ose laptop), dhe më pas mund të dëgjoni skedarët audio të ruajtur në pajisje me anë të bokseve SoundBar.

Çfarë ju duhet

- Një pajisje Bluetooth që mbështet profilin Bluetooth A2DP dhe AVRCP, dhe me Bluetooth versioni 4.2 ose më të ri.
 - Rrezja funksionale mes SoundBar dhe një pajisjeje Bluetooth është rrëth 4 metra.
- 1 Shtypni  në telekomandë për ta kaluar SoundBar në modalitetin Bluetooth.
→ Treguesi i SoundBar pulson ngjyrë blu.
- 2 Në pajisjen Bluetooth, ndizni Bluetooth, kërkon dhe zgjidhni **Philips HTL1520B** për të filluar lidhjen (shikoni manualin e përdorimit të pajisjes Bluetooth përményrën se si të aktivizoni Bluetooth).
→ Gjatë lidhjes, treguesi i SoundBar pulson ngjyrë blu.
- 3 Prisni që treguesi i SoundBar të bëhet ngjyrë blu solide.
→ Nëse lidhja dështon, treguesi pulson pa ndërprerje me ritëm më të ulët.
- 4 Zgjidhni dhe luani skedarë audio ose muzikë në pajisjen Bluetooth.
 - Gjatë luajtjes, nëse vjen një telefonatë, luajtja e muzikës ndalon.
 - Nëse pajisja Bluetooth mbështet profilin AVRCP, mund të shtypni  /  në telekomandë për të kapërcyer te një këngë, ose shtypni  për të ndaluar/vazhduar luajtjen.
- 5 Për të dalë nga Bluetooth, zgjidhni një burim tjetër.
 - Kur riktheheni në modalitetin Bluetooth, lidhja Bluetooth qëndron aktive.

Shënim

- Transmetimi streaming i muzikës mund të ndërpritet nga pengesat mes pajisjes dhe SoundBar si muri, kasa metalike që mbulon pajisjen, ose pajisje të tjera pranë që punojnë në të njëjtën frekuencë.
- Nëse doni ta lidhni SoundBar me një pajisje tjeter Bluetooth, shtypni dhe mbani shtypur  në telekomandë për ta shkëputur pajisjen Bluetooth të lidhur aktualisht.

Gjendje pritjeje automatike

Kur luani media nga një pajisje e lidhur, ky produkt kalon automatisht në gjendje pritjeje pas 15 minutash mungese aktiviteti në butona dhe nëse nuk luhet audio nga një pajisje e lidhur.

Vendosja e konfigurimeve të fabrikës

Mund t'i rivendosni konfigurimet e fabrikës në SoundBar.

- 1 Në modalitetin LINE, mbanı shtypur butonin e energjisë të telekomandës për 5 sekonda.
→ Konfigurimet e fabrikës do të rivendosen.

Përditësimi i softuerit

Për ta përmirësuar vazhdimisht produktin, mund të ofrohet përditësimi i produktit. Viziton www.philips.com/support për të parë nëse është në dispozicion versioni më i fundit i softuerit.


5 Montimi në mur

Shënim

- Montimi i papërshtatshëm në mur mund të shkaktojë aksidente, lëndime ose dëmtime. Nëse keni ndonjë pyetje, kontaktoni shërbimin e klientit në vendin tuaj.
- Para se ta montoni në mur, sigurohuni që muri është në gjendje të mbajë peshën e SoundBar.

Gjatësia/diametri i vidës

Në varësi të mënyrës së montimit të SoundBar në mur, sigurohuni që të përdorni vida me gjatësi dhe diametër të përshtatshëm.



Shikoni figurën në udhëzuesin e shpejtë për mënyrën se si ta montoni SoundBar në mur:

- Shponi dy vrima në mur.
- Fiksoni upat dhe vidat në vrima.
- Vareni SoundBar në vida.

6 Të dhënat e produktit

Shënim

- Të dhënat dhe dizajni mund të ndryshohen pa u njoftuar përpëra.

Amplifikatori

- Fuqia totale output RMS:
70 W RMS (+/- 0,5 dB, 10% THD)
- Përgjigja e frekuencës: 50 Hz - 15 kHz / ± 3 dB
- Raporti sinjal-zhurmë:
> 65 dB (CCIR) / (me vlerësimin A)
- Shtrembërimi harmonik total: < 1%
- Ndjeshmëria input:
 - LINE IN: 450 mV +/- 50 mV

Audio

- Hyrja audio S/PDIF Digital:
 - Optike: TOSLINK
- Frekuencia Sampling:
 - MP3: 8 kHz, 11 kHz, 12 kHz, 16 kHz, 22 kHz, 24 kHz, 32 kHz, 44,1 kHz, 48 kHz
- Bit-rate konstant:
 - MP3: 8 kbps-320 kbps

Bluetooth

- Profillet Bluetooth: A2DP AVRCP
- Versioni i Bluetooth: 5.0
- Banda e frekuencës/Fuqja output:
2402 - 2480 MHz / ≤ 20 dBm

Njësia kryesore

SoundBar

- Furnizimi me energji: 100-240 V~, 50/60 Hz
- Konsumi i energjisë: 15 V/1,6 A
- Konsumi i energjisë në gjendje pritjeje: ≤ 0,5 W
- Përmasat (Gje x La x The): 960 x 67,8 x 85,5 mm
- Pesa: XX kg
- **Bokset e brendshme:** 2 x rreze e plotë (52 mm/2", 4 ohm)

Subwoofer

- Furnizimi me energji: 100-240 V~, 50/60 Hz
- Konsumi i energjisë: 20 W
- Konsumi i energjisë në gjendje pritjeje: ≤ 2 W
- Përmasat (Gje x La x The): 155 x 252 x 205 mm
- Pesa: XX kg
- **Bokset e brendshme:** 1 x frekuencë e ulët (118 mm/4,5", 6 ohm)

Bateritë e telekomandës

- 1 x AAA-R03-1,5 V

Informacione për gjendjen në pritje

- Kur produkti qëndron joaktiv për 15 minuta, ai kalon automatikisht në gjendje pritjeje ose në gjendje pritjeje në rrjet.
- Kur produkti (SoundBar ose Subwoofer) qëndron në gjendje pritjeje, konsumi i energjisë është më pak se 2 W.
- Për ta çaktivizuar lidhjen Bluetooth, shtypni dhe mbani shtypur butonin Bluetooth në telekomandë.
- Për të aktivizuar lidhjen Bluetooth, aktivizoni lidhjen Bluetooth në pajisje.

7 Zgjidhja e problemeve

Paralajmërim

- Rrezik goditjeje elektrike. Asnjëherë mos e hiqni kasën e produktit.

Për ta mbajtur garancinë të vlefshme, asnjëherë mos u mundoni ta riparoni produktin vetë.

Nëse keni probleme me përdorimin e produktit, kontrolloni pikat e mëposhtme para se të kërkonit servis.

Nëse ende keni problem, kërkonit ndihmë në www.philips.com/support.

Njësia kryesore

Butonat në SoundBar nuk punojnë.

- Shkëputeni SoundBar nga energjia për pak minuta, më pas lidheni përsëri.

Zëri

Nga SoundBar nuk del zë.

- Lidhni kabullin e audios nga SoundBar në televizor ose në pajisjet e tjera.
- Rivendosni konfigurimet e fabrikës në SoundBar.
- Zgjidhni hyrjen e duhur të audios në telekomandë.
- Sigurohuni që SoundBar nuk është i heshtur.

Tingulli është i shtrembëruar ose ka eko.

- Nëse luani audio nga televizori nëpërmjet SoundBar, sigurohuni që televizori nuk është heshtur.

Bluetooth

Pajisja nuk mund të lidhet me SoundBar.

- Pajisja nuk mbështet profilet e pajtueshme që nevojiten për SoundBar.

- Nuk keni aktivizuar funksionin Bluetooth në pajisje. Shikoni manualin e përdorimit të pajisjes për të parë se si ta aktivizoni funksionin.
- Pajisja nuk është lidhur si duhet. Lidheni pajisjen si duhet. (shikoni "Luajtja e audios nëpërmjet Bluetooth" në faqen 10)
- SoundBar është lidhur tashmë me një pajisje tjeter Bluetooth. Shkëputeni pajisjen e lidhur, pastaj provoni përsëri.

Cilësia e luajtjes së audios nga një pajisje

Bluetooth është i dobët.

- Sinjali Bluetooth është i dobët. Çojeni pajisjen më pranë SoundBar, ose hiqni çdo pengesë mes pajisjes dhe SoundBar.

Pajisja Bluetooth e lidhur lidhet dhe shkëputet vazhdimesht.

- Sinjali Bluetooth është i dobët. Çojeni pajisjen më pranë SoundBar, ose hiqni çdo pengesë mes pajisjes dhe SoundBar.
- Çaktivizoni funksionin Wi-Fi në pajisjen e lidhur për të shmangur interferencat.
- Në disa pajisje Bluetooth, lidhja Bluetooth mund të çaktivizohet automatikisht për të kursyer energji. Kjo nuk tregon se ka ndonjë problem me SoundBar.



Bluetooth®

Fjala dhe logot Bluetooth® janë marka tregtare të regjistruara që zotërohen nga Bluetooth SIG, Inc.

Të dhënat mund të ndryshohen pa u njoftuar përpara.

Philips dhe Philips Shield Emblem janë marka tregtare të regjistruara të Koninklijke Philips N.V. dhe përdoren me licencë. Ky produkt është prodhuar nga, dhe shitet nën përgjegjësinë e MMD Hong Kong Holding Limited, ose të një prej filialeve të tij, dhe MMD Hong Kong Holding Limited është garantuesi i vetëm në lidhje me këtë produkt.

